

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot më datë 20.06. 2003, unë Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Shkëlze Çepo, pasi shqyrtova kërkesën e kërkuarit Rezart Taçi, i cili më kërkoi regjistrimin e Shoqërisë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh. a. si Person Juridik Privat.

K O N S T A T O V A :

Kërkuari Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë Tregtare në formim e sipër, "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, kërkon të regjistrojë Shoqërinë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. me seli në adresën: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. "Sky Tower", kati 4, Tiranë, me objekt të veprimtarisë si më poshtë :

- blerjen, importimin, shitjen e naftës dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- blerjen, importimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 2 000 000 (dy milion) LEKË.

Aksionerë të Shoqërisë janë :

1. Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë.
2. Zoti Rezart Taçi, zotëron 55%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është me kohëzgjatje pa afat.

Shoqëria që në momentin e themelimit të saj ka zgjedhur edhe organet e para drejtuese. Drejtor i Shoqërisë do të jetë zoti Rezart Taçi, me anëtarë të Këshillit Mbikqyrës z. Mustafa Taçi, zj. Adriana Veizaj dhe zj. Drita Aliçkaj. Ekspert kontabël i shoqërisë do të jetë Zoti Paqsor Qato.

Për sa më sipër kërkesa e bërë prej saj është plotësisht e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të ligjit nr.7638 datë 10.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" e ligjit nr.7667 datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

VENDOSA :

Të regjistroj si Person Juridik Privat, Shoqërinë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. me seli në qytetin e Tiranës adresa Rruga: "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. "Sky Tower" kati i 4, me objekt të veprimtarisë si me poshtë :

- blerjen, importimin, shitjen e naftës dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- blerjen, importimin, transportimin, edhe për llogari të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzave dhe i garancive të tjera.


Afati i shoqërisë do të jetë me kohëzgjatje pa afta.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 2.000.000 lekë dhe është i shpërndarë si më poshtë:

1. Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar.
2. Zoti Rezart Taçi, zotëron 55%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar.

Organet drejtuese të shoqërisë janë Asamblea e Aksionerëve e përbërë nga aksionerët themelues, Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. do të jetë zoti Rezart Taçi, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë është i përbërë nga z. Mustafa Taçi, zj. Adriana Veizaj dhe zj. Drita Aliçkaj. Ekspert i Parë Kontabël është zgjedhur z. Paqsor Qato.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 29896 / Vendimit

11

V E N D I M
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 13-9-2004, unë D. Ponaqoshi Gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Z. Petref Merkaj, në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., i cili më kërkoi depozitimin e vendimit datë 10.06.2004, të Këshillit Mbikqyrës të kësaj shoqërie, dhe pasi e shqyrtova atë,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, të datës 10.06.2004, është diskutuar rendi i ditës për sa i përket miratimit të dorëheqjes së Drejtorit aktual të shoqërisë Z. Rezart Taçi dhe emërimit të Drejtorit të ri të Shoqërisë Z. Petref Merkaj. Ky vendim i Këshillit Mbikqyrës është marrë në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Lijgin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare"

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., është e plotë dhe e bazuar në ligj dhe në aktet e themelimit të Shoqërisë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., datë 10.06.2004 për pranimin e dorëheqjes së Drejtorit aktual Z. Rezart Taçi dhe emërimin e Drejtorit të ri të Shoqërisë Z. Petref Merkaj / _____
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet në kollonën përkatëse.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligj.

GJYQTARE
Regjete Ponaqoshi
2004

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 29896/2 Vendimit

V E N D I M
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 24.06 2005, unë M. Murr Gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Z. Rezart Taçi, në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., i cili më kërkoi depozitimin e vendimit datë 17.06.2005, të Këshillit Mbikqyrës të kësaj shoqërie, dhe pasi e shqyrtova atë,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, të datës 17.06.2005, është diskutuar rendi i ditës për sa i përket miratimit të dorëheqjes së Drejtorit aktual të shoqërisë Z. Petref Merkaj dhe emërimit të Drejtorit të ri të Shoqërisë Z. Rezart Taçi. Ky vendim i Këshillit Mbikqyrës është marrë në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Lijin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare"

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., për depozitimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, datë 17.06.2005, është e plotë dhe e bazuar në ligj dhe në aktet e themelimit të Shoqërisë dhe si e tillë duhet pranuar.


PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Tregtare "TAÇI OIL" Sh.a., datë 17.06.2005 për pranimin e dorëheqjes së Drejtorit aktual Z. Petref Merkaj dhe emërimin e Drejtorit të ri të Shoqërisë Z. Rezart Taçi.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrin Tregtar të bëjë ndryshimet në kollonën përkatëse.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligj.

GJYQTARE


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 29896/2 Vendimi

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 13.7 2005, unë Z. Paqsor Qato, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuetit Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.p.k, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 24.06.2005, për zmadhimin e kapitalit dhe caktimin e ekspertit për zmadhimin,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkueti, Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, për pjesën e jashtëzakonshme, datë 24.06.2005. Me anë të këtij vendimi të asamblesë, në pjesën ku është vendosur për çëshjtet e jashtëzakonshme është dhënë miratimi për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributit në holla, i përbërë nga fitimet mbartura të realizuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj dhe që nuk janë tërhequr nga aksionerët. Për të realizuar këtë zmadhim është e nevojshme caktimi i ekspertit kontabël të autorizuar i cili do të përcaktojë vlerën e kontributit nëpërmjet raportit për zmadhimin e kapitalit. Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë në të njëjtin vendim propozon caktimin si ekspertë për zmadhimin të ekspertit kontabël të autorizuar Z. Paqsor Qato.

Ky vendim i Asamblesë së Aksionerëve, datë 24.06.2005 është marrë në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.1.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe dispozitave përkatëse të Statutit të Shoqërisë.

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.p.k., datë 28.06.2005, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqërisë Tregtare” dhe të ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrimin Tregtar”,

VENDOSA


1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimn e Vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY Sh.p.k., datë 24.06.2005, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë dhe caktimin e ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin.
3. Emërohet si ekspertë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqsor Qato.
4. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar për kryerjen e ndryshimeve në kollonën përkatëse të Regjistrimit Tregtar.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE
Blendi Lajçi
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr. 29896/9 Vendimi

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 22.10. 2005, unë , gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 31.10.2005, dhe pasi e shqyrtova atë,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuari, Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 31.10.2005, me anën e të cilit është vendosur të miratohet raporti për zmadhimin e kapitalit, i hartuar nga eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqësor Qato, i caktuar me vendim Gjykate. Me të njëjtin vendim është vendosur për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë dhe ndryshimi i një dispozite të Statutit të shoqërisë.

Sipas raportit të ekspertit është parashikuar zmadhimi i kapitalit nga vlera aktuale e kapitalit të nënshkruar prej 2.000.000 lekë në vlerën 19.247.278 lekë. Zmadhimi është realizuar nëpërmjet kontributit në të holla të përfaqësuar nga fitimet e mbartura, si dhe nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese nga 1000 në 9623,64 lekë. Në raport është bërë edhe paraqitja e pjesmarrjes së ortakëve në kapitalin e shoqërisë pas rritjes.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve me vendimin e datës 31.10.2005, ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 19.247.278 lekë.

Së fundi Asambleja e Aksionerëve ka vendosur të ndryshojë dhe nenin 5 të Statuti në të cilën parashikohet kapitali themeltar dhe përqindjet përkatëse.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL

TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., datë 31.10.2005, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 “Për Rregjistrin Tregtar”,

V E N D O S A :


1- Pranimin e kërkesës.

2- Depozitimn e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Tregtare “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., datë 31.10.2005, për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në të holla të përfaqësuar nga fitimet e mbartura, si dhe nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese nga 1000 në 9623,64 lekë, për zmadhimin e kapitalit dhe për një ndryshim në Statutin e Shoqërisë.

3- Urdhërohet Zyra e Regjistrin Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANE
Nr. 29896/5 Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, më datë 14.04.2007, unë M. Juma gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Rezart Taçi, Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.

KONSTATOVA

Se shoqëria "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. është regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.29896 datë 20/06/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë me Vendimin Nr.6 datë 02/04/2007 ka vendosur:

1. Miratimin e shitjes së 45 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., të zotëruara nga aksionari Fation Veizaj tek aksionari z. Rezart Taçi.
2. Me transferimin e pronësisë së 45 % të aksioneve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. tek aksionari z. Rezart Taçi, z. Fation Veizaj çlirohet nga çdo detyrim i tij personal ndaj shoqërisë apo të tretëve dhe çdo garanci apo dorëzani e tij personale, dhënë të tretëve për shoqërinë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., hiqet duke dhënë garanci apo duke u bërë dorëzanës për to aksionari z. Rezart Taçi.
3. Me realizimin e shitjes, çdo barrë e vendosur mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme të z. Fation Veizaj për llogari të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. hiqet në mënyrë imediate e definitive dhe detyrimin për të garantuar të tretët e merr përsipër aksionari z. Rezart Taçi.
4. Ndryshimin e Nenit 5 të Statutit të shoqërisë për sa i përket përbërjes së aksionarëve dhe zotërimit të aksioneve të kapitalit, që ndryshon dhe bëhet si më poshtë:
 - z. Rezart Taçi zotëron 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë që janë të barabarta me 2000 aksione, me vlerë 19.247.278 lekë.

5. Pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijim të këtij vendimi është nënshkruar dhe kontrata e shitblerjes së aksioneve nr.487 rep., nr.147 kol., datë 05/04/2007 e noteres Sofika Braka.


Kërkesa e tij është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KETO ARSYE

Duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" e Ligjin Nr.7667 datë 28/01/1993 "Për Regjistrin Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. Nr.6 datë 02/04/2007 dhe të kontratës së shitblerjes së aksioneve nr.487 rep., nr.147 kol., datë 05/04/2007.
- Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të beje shënimet përkatëse në skedën e shoqërisë në kolonën _____.

GJYQTARE


22836

India report

Quarterly "Basic Oil International"

Working of Supply Commission -

Supply of some items

The Dept. Supply and Disposal

Notes

N.W. Agency Report for

the Ministry of Commerce

Quarterly Report

Supply Commission

Supply of some items

The Dept. Supply and Disposal

Notes

Supply Commission

Supply of some items

Supply Commission

STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME
“TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” SH. A

KAPITULLI I
FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË



Neni 1
Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionerëve themelues të shprehur në kontratën e themelimit si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” themelohet Shoqëria Tregtare “Taçi Oil International Trading & Supply Company” Sh.a. e cila do të funksionojë sipas dispozitave të kontratës së themelimit dhe këtij statuti.

Neni 2

Shoqëria ka për objekt veprimtarie të saj :

- blerjen, importimin, shitjen e naftës dhe vajrave minerale të papërpunuar;
- blerjen, importimin, transportimin, edhe për llogari të tretëve, depozitimin, përzjerjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

Neni 3
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë do të jetë “Taçi Oil International Trading & Supply Company” Sh.a. Shoqëria në qarkullimin juridiko-civil përdor dhe shkurtimin e emërtimit i cili është “TATRASCO” sh.a.

NENI 4

Selia, Agjensitë dhe Zyrat e Përfaqësimit

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall. “Sky Tower”, kati 4, Tiranë.

Veprimtaria e shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët dhe agjensitë e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë.

Shoqëria mund të çelë degë, agjensi dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato çelen dhe prishen me vendim të Këshillit Mbikqyrës.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET NDRYSHIMET E KAPITALIT

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 lekë. Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1 000 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

Aksionet janë të numëruara nga 1 deri 2 000 aksionë dhe janë të shpërndara në këtë mënyrë:

1. Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45% të akcioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë, që janë të barabarta me 900 numër të akcioneve me vlerë 900.000 lekë.
2. Zoti Rezart Taçi, zotëron 55%, të akcioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë, që janë të barabarta me 1100 numër të akcioneve me vlerë 1.100.000 lekë.

Neni 6 Forma e aksioneve

Aksionet e Shoqërisë janë nominative.

Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionerëve, Shoqëria i lëshon atyre një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.

Aksionet janë të pandashme. Pronarët e aksioneve përfaqësohen në shoqëri nga aksionerët, të cilët konsiderohen si pronarët e vetëm të zgjedhur.

Neni 7 Shitja dhe transferimi i aksioneve

Përveç rastit të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet tek një i tretë, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga asamblea e aksionerëve.

Në qoftë se Këshilli Mbikqyrës ka refuzuar shitjen e aksioneve një blerësi jashtë bashkësisë së aksionerëve, shitësi duhet të njoftojë shoqërinë me letër rekomande brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të realizimit, nëse ka hequr dorë nga projekti i shitjeve të aksioneve. Në rast se shitësi nuk ka hequr dorë nga ky projekt, Këshilli Mbikqyrës duhet të sigurojë blerjen e aksioneve prej një ose disa persona të zgjedhur prej tij.

Në qoftë së, për vlerësimin e aksioneve nëvojitet nje akt ekspertimi shpenzimet e ekspertit paguhen përgjysëm të ndara midis shitësit dhe blerësit.



Neni 8

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 150 deri 163 të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, në bazë të raportit të Drejtorisë, të hartuar në mënyrën e kërkuar nga ligji.

Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë për nënshkrimin e aksioneve të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është në përpjestim me shumën e aksioneve të zotëruara nga aksionerët përpara zmadhimin të kapitalit.

Aksionerët mund të heqin dorë vetëm individualisht nga e drejta për nënshkrimin e aksioneve të reja. Ata, gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojnë nënshkrimin e një numri më të vogël aksionesh nga sa u takon sipas parimit të përpjestueshmërisë, por me kusht që Asambleja të ketë vendosur shprehimisht për këtë gjë.

Neni 9

Shlyerja e aksioneve

Aksionet për kapitalin në para të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit do të shlyhen për 100 përqind të vlerës së tyre që në çastin e nënshkrimit. Pjesa tjetër e vlerës do të shlyhet me këste, në bazë të kërimit për shlyerje nga Këshilli Mbikqyrës brenda një afati 3 vjet nga data kur zmadhimi i kapitalit është kryer përfundimisht.

Asambleja e Jashtëzakonshme që vendos zmadhimin e kapitalit, ka të drejtë të marrë vendimin për shlyerjen tërësore të aksioneve që në çastin e nënshkrimit ose brenda një afati më të shkurtër, nga ai i përmendur në paragrafin e dytë të këtij Neni.


Kërkimi i fondeve u njoftohet nënshkruarve të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me letër rekomande dhe me kthim përgjigje, drejtuar çdo pronari të aksioneve.

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të kërkuara sjell pagimin e interesave sipas përqindjeve të caktuara me ligj, duke filluar nga data e kërimit të çdo derdhjeje pa qenë nevoja për të proceduar në formalitete të tjera të çfarëdoshme dhe pa hequr dorë nga veprimet e Shoqërisë ndaj aksionerit detyruar dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara, nga ligji.

Neni 10

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Përgjithshme të Jashtëzakonshme të aksionerëve dhe në pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të çënojë raportet e aksionerëve para këtij zvogëlimi.



Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet në shumën minimale të kërkuar nga ligji.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet.

Çdo aksioner jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të shoqërisë të destinuara për shpërndarje dhe në tepricën e aktivitetit të mbetur në rastin e likuidimit, në përpjestim me aksionet që zotëron.

Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në statut.

Aksioneri përgjigjet për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.

Kur aksionet u kalojnë aksionerëve të rinj, këta ruajnë të drejtat e detyrimeve që vijnë nga aksionet.

Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në statutin e shoqërisë dhe në vendimet e asamblesë së përgjithshme.

KAPITULLI III DREJTIMI I SHOQËRISË

Seksioni I Drejtoria

Neni 12

Përbërja dhe emërimi

Drejtimi i përgjithshëm i shoqërisë kryhet nga Drejtoria

Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikqyrës.

Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. do të jetë Zoti Rezart Taçi.

Drejtori i ushtron funksionet e tij nën kontrollin e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 13

Kohëzgjatja e funksionëve të Drejtorisë.

Drejtori Ekzekutiv emërohet për një periudhë të pakufizuar.

Ai mund të shkarkohet nga detyra e tij me vendim të Këshillit Mbikqyrës për shkaqe të përligjura.


Në qoftë se vendi i drejtorit mbetet bosh, zëvendësimi i tij bëhet nga Këshilli Mbikqyrës. Anëtari zëvendësues emërohet për periudhën që mbetet deri në emërimin pasardhës të antarit tjetër të drejtorisë.

Neni 14

Shkarkimi i Drejtorit

Drejtori mund të shkarkohet gjatë mandatit të tij :

1. Eshhtë shpallur fajtor me vendim të formeës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale që ka lidhje me veprimtarinë ekonomiko- financiare.



2. Është vertetuar se ka shpërdoruar fondet e shoqërisë.
3. Janë rastet e parashikuara në nenin 98 të Ligjit Nr.7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 15
Përfaqësimi i shoqërisë

Shoqëria përfaqësohet nga Drejtori i saj ose i autorizuari i tij para të gjithë institucioneve publike e private, organeve gjyqësore si dhe në marrëdhëniet me të tretët.

Neni 16
Mbledhjet e drejtorisë dhe vendimet

Mbledhja e drejtorisë drejtohet nga Drejtori i saj ose personi i autorizuar rregullisht prej tij.

Mbledhjet e drejtorisë zhvillohen, si rregull, në selinë e shoqërisë. Ato drejtohen nga Drejtori i saj që kryen edhe procedurat e nevojshme për thirrjen e mbledhjes.

Neni 17
Kompetencat e Drejtorisë

Drejtori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë në çdo rrethanë. Ajo i ushtron keto kompetenca brenda kufijve të objektit të shoqërisë, dhe kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shprehimisht Këshillit Mbikqyrës dhe Asamblesë së Aksionerëve.


Neni 18
Operacione të autorizuara

Drejtoria kërkon autorizim paraprak nga Këshilli Mbikqyrës për :

- krijimin e garancive nëpërmjet pasurisë së shoqërisë;
- kryerja e investimeve që nuk përfshihen në programin financiar vjetor;
- çeljen e veprimtarive ose degëve e agjencive të reja;
- shkrirja, bashkimi dhe mbyllja tërësisht ose pjesërisht e veprimtarive dhe degëve të shoqërisë;
- pjesmarrja në shoqëri të tjera;
- shitja dhe shkëmbimi i pasurive që përbëjnë aktive të qëndrueshme të shoqërisë;
- lidhjen ose ndryshimin e kontratave që kapërcejnë vlerën e caktuar nga Këshilli Mbikqyrës.

Neni 19
Shpërblimi i Anëtarit të Drejtorisë


Masa e shpërblimit të Drejtorit Ekzekutiv caktohet nga Mbledhja e Asamblesë të Aksionerëve.



Neni 20

Përgjegjësia e Anëtarëve të Drejtorisë

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës, civilisht dhe penalisht për aktet e drejtimit të tyre, në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.



Seksioni II Këshilli Mbikqyrës

Neni 21

Përbërja dhe emërimi

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre anëtare.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionerëve dhe 2/3 e tyre nuk kanë statusin e të punësuarit në shoqëri.

Neni 22

Person Juridik, anëtar i këshillit mbikqyrës

Një person juridik që është aksioner i shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Në këtë rast ky duhet të caktojë, që në çastin e zgjedhjes, një përfaqësues të përhershëm person fizik, i cili u nënshtrohet të njëjtave kushte dhe detyrimeve dhe ka të njëjta përgjegjësi civile e penale si të ishte ai vetë anëtar i Këshillit, duke mos përjashtuar nga përgjegjësia e përbashkët edhe personin juridik që ai përfaqëson.

Në qoftë se personi juridik i revokon mandatin përfaqësuesit të tij, ai duhet të njoftojë për këtë shoqërinë pa vonesë dhe të bëjë zëvendësimin e tij. Ky rregull do të zbatohet edhe në rastet e vdekjes, të dorëheqjes ose të pengimeve të zgjata të përfaqësuesit të përhershëm.

Neni 23

Kohëzgjatja e funksioneve dhe vendet boshë

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është tre vjet por s' duhet të kalojë 6 vjet. Një vit është periudha midis dy mbledhjeve vjetore të Asamblesë të Përgjithshme.

Në qoftë se një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga asambleja mbeten bosh për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose një pengimi për një kohë të gjatë, Këshilli njofton Asambleshën e Aksionerëve, të cilët bëjnë zëvendësimet përkatëse.

Neni 24

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës, nga përbërja e tij ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit.

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës janë persona fizike dhe nuk mund të zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të personave juridik apo anëtarëve të zgjedhur nga të punësuarit e shoqërisë.

Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës mund të rizgjidhen. Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar të zgjedhur midis anëtarëve të keshillit ose jashtë tyre duke caktuar edhe kohëzgjatjen e funksioneve të këtij.

Neni 25

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës. Quorumi

Këshilli Mbikqyrës mbledhet me thirrjen e kryetarit, ose në rast pengimi të këtij, të zëvendëskryetarit, sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë dhe sa herë shtrohen çështje për tu zgjidhur dhe që janë në kompetencë të këtij Këshilli. Në çdo rast Këshilli duhet të mbledhet detyrimisht një herë në tre muaj.

Thirrja e keshillit bëhet me çdo lloj mënyre.

Kryetari i Këshillit Mbikqyrës, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit brenda 15 ditësh kur Drejtori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës i paraqit një kërkesë të motivuar për këtë. Në qoftë se kërkesa nuk merr përgjigje, kërkuetit mund të procedojnë vetë me thirrjen e mbledhjes të Këshillit Mbikqyrës, duke treguar rendin e ditës të mbledhjes.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në selinë, e shoqërisë.

Rendi i ditës vendoset nga kryetari ose, në mungesë të tij nga zëvendëskryetari, ose nga anëtari i drejtorisë apo anëtarët e Këshillit Mbikqyrës që kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës mund t'i japë mandat një anëtari tjetër për ta përfaqësuar në një seancë të Keshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës janë të vlefshme kur numri, i anëtarëve të pranishëm, në mbledhje është të paktën sa gjysma e anëtarëve në funksion.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar. Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit është përcaktuese.

Në selinë e shoqërisë mbahet një regjistër i pranisë, i cili firmoset nga anëtarët e keshillit pjesëmarrës në seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidentohen me procesverbale të hartuara në një regjistër të posaçëm, i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në selinë e shoqërisë, në të cilin trogohen anëtarët e pranishëm, të përfaqësuar dhe që mungojnë si dhe çdo person që ka asistuar në mbledhje, tërësisht apo pjesërisht.

Proçes verbalet firmosen nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Neni 26


Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës ushtron mbikqyrje në mënyrë të përhershme në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë nga ana e Drejtorisë. Ai vendos për operacionet që duhet të kryhen me autorizim të tij në bazë të Nenit 19 të këtij statuti.

Këshilli Mbikqyrës miraton programet vjetore të zhvillimit të shoqërisë si dhe planin e saj ekonomiko-financiar dhe ia paraqet për miratim, përfundimisht Asamblesë së Aksionerëve.

Këshilli Mbikqyrës miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, kriteret e punësimit dhe të pagave si dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

Në çdo kohë të vitit, Këshilli Mbikqyrës kryen të gjitha verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe ka të drejtë të kërkojë të njihet me dokumentet që ai



gjykon të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tij. Një herë në tre muaj ai merr një raport të paraqitur nga Drejtori.

Brenda tre muajve nga mbyllja e çdo viti financiar Drejtori i paraqit atij me qëllim verifikimi e kontrolli. Ilogaritë vjetore si dhe një raport të shkruar për gjendjen e shoqërisë dhe aktivitetet e saj gjatë vitit financiar të mbyllur.

Neni 27

E drejta për informim e anëtarëve të Këshillit

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Drejtori informacion për çështje të natyrës administrative, teknike dhe financiare që i mundësojnë atij të verifikojë dhe gjykojë për kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e shoqërisë dhe të jetë plotësisht i qartë për vendimet që duhen marrë apo që do të merren nga ana e këshillit.

Kryetari i Këshillit ka përgjegjësinë për t'i venë anëtarët e Këshillit në gjendje që të marrin informacionet e kërkuara.

Çdo anëtar i Këshillit duhet të njoftohet personalisht për mbledhjet e Këshillit dhe t'i vihen në dispozicion në selinë e shoqërisë apo t'i dërgohen bashkë me thirrjen dokumentet dhe raportet që do të shqyrtohen në mbledhje.

Shoqëria nuk është e detyruar t'i japë anëtarëve të Këshillit drejtues kopjo të proces verbaleve të vendimeve të këshillit, por çdo anëtar mund të kërkojë që të njihet me to në selinë e shoqërisë.

Mosnjohja e të drejtave të çdo anëtari të Këshillit për informacionet e mësipërme dhe mos thirrja në mbledhjen e këshillit sjell pavlefshmërinë e vendimeve të Këshillit.

Neni 28

Shpërblimi për anëtarësinë në këshill dhe shpërblimet e jashtëzakonshme

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme, mund t'u caktojë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës si shpërblim për pjesëmarrjen në këshill një shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri në një vendim të kundërt të asamblesë.

Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për anëtarët të cilëve u ngarkohen shërbime apo detyra të caktuara. Shpërblimet e jashtëzakonshme i nënshtrohen miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e zakonshme sipas rregullave të parashikuara nga nenet 122 deri 125 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Shpërblimet e veçanta dhe të jashtëzakonshme përballohen nga llogaria e shoqërisë dhe kalohen në shpenzimet e saj.

Përveç shpërblimeve të përmendura në këtë nen, anëtarëve të Këshillit nuk u caktohet asnjë shpërblim tjetër i përhershëm ose jo.

Seksioni III

DISPOZITA TË PERBASHKËTA PËR DREJTORINË DHE ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Neni 29

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe Drejtorit ose të Këshillit Mbikqyrës, që lidhet drejtpërdrejtë, apo me të cilën një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt

apo nëpërmjet një personi ndërmjetës të autorizohet paraprakisht nga Këshilli Mbikqyrës.

Kryetari i Këshillit Mbikqyrës njofton ekspertin kontabël të autorizuar për marrëveshjet e autorizuara një muaj përpara se marrëveshja të lidhet dhe i shtron këto marrëveshje për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertët Kontabël të Autorizuar i paraqitin Asamblesë një raport të posaçëm për këto marrëveshje, e cila vendos mbi këtë raport.

Dispozitat e nësipërme nuk zbatohen për marrëveshjet që kanë të bëjnë me operacionet rregullorë dhe të kryera në kushte normale.

Neni 30

Marrëveshjet e ndaluara

Anëtarëve të drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës, u ndalohet të kontraktojnë që të marrin hua nga shoqëria, t'u akordohet nga shoqëria një zbulim me llogari rrjedhëse ose në një formë, tjetër, si dhe të bëjnë shoqërinë dorezanëse apo garante për detyrimet e tyre ndaj të tretëve. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin kur këta persona kontraktojnë me shoqërinë për marrjen e tyre në sigurim apo për marrjen e veprimtarive dhe mallrave që lidhen me këto veprimtari në sigurim ose që lidhen direkt me karkaterin e tyre diagnostikues dhe kurues.

Ky ndalim zbatohet për përfaqësuesit e përhershëm të personave juridik anëtarë të Këshillit Mbikqyrës si dhe për bashkëshortët, paraardhësit dhe, pasardhësit e personave të përmendur në këtë nen si dhe për çdo person ndërmjetës.

Neni 31

Detyrimet për ruajtjen e sekretit

Drejtori dhe antarët e Këshillit Mbikqyrës si dhe çdo person tjetër që asiston në mbledhjet e këtyre, organeve duhet të ruajnë fshetësinë për çështjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendshëm.

KAPITULLI IV ASAMBLEA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

Neni 32

Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve


Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme në vartësi të natyrës të çështjeve që diskutohen dhe vendimeve që do të marrë.

Çdo asamble e përgjithshme e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksioneri i vetëm.

Neni 33

Organizimi i mbledhjeve të asamblesë

Asambleja e përgjithshme thirret nga Këshilli Mbikqyrës ose nga drejtoria. E drejta për thirrjen e mbledhjes nga Drejtoria bëhet mbi bazën e rregullave të funksionimit të saj si organ kolegjal. Mbledhja e Asamblese mund të thirret, gjithashtu, nga Eksperti



Kontabel i Autorizuar i pavarur në rastë urgjence, nga nje mandatmbajtës i caktuar nga gjykata dhe kur është rasti, nga likuiduesi.

Asambletë e pergjithshme mblidhen në selinë e shoqerise ose në cdo vend tjetër të treguar në thirrje.

Thirrja e asamblesë së aksionerit të vetëm bëhet me anë të njoftimit që i dërgohet atij në adresën e tij me letër rekomande.

Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionerit apo të njihet prej tyre 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë dhe duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e asamblesë dhe rendin e ditës.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar quorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes të mbledhjes se dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

Neni 34

Rendi i ditës

Rendi i ditës së mbledhjes së asamblesë përcaktohet nga autori i thirrjes.

Aksionerët përcaktojnë rendin e ditës.

Këto projekt rezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me një kërkesë në të cilën tregohen edhe arsyet, si dhe me një dokument që provon zotërimin e pjesës të kapitalit themeltar të kërkuar nga paragrafi i dytë i ketij Neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Asambleja e aksionerëve nuk mund të marrë, në shqyrtim një çështje që nuk është përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë ajo mundet, në çdo rrethanë të shkarkojë një ose disa anëtarë të Këshillit Mbikqyrës dhe të bëjë zëvendësimin e tyre.

Neni 35


Evidenca e pjesmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet.

Për çdo mbledhje të asamblesë mbahet një fletë-pranie e cila përmban treguesit që provojnë identitetin e aksionerëve dhe aksionet e zotëruara prej tyre. Fletë-prania firmoset në anë nga aksioneri ose, kur është rasti, nga përfaqësuesi i tij dhe vertëtetohet për saktësinë e saj nga komisioni vëzhgues i mbledhjes.

Për çdo mbledhje të asamblesë hartohet një proces verbal i cili përmban :

- datën dhe vendin e mbledhjes
- mënyrën e thirrjes
- rendin e ditës
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vëzhgimit
- numri i aksionerëve që marrin pjesë në votim,
- quorumi i arritur
- përmendjen e dokumentave dhe të raporteve që janë shtruar në mbledhje
- një përmbledhje të debateve
- tekstet e projektrezolutave të vëna në votim, ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë nga aksionerët.
- rezultatet e votimeve

Proces verbalet e mbledhjes të asamblesë hartohen në nje regjistër të posaçëm, i numërtuar dhe i vulosur, i cili ruhet në selinë e shoqërisë.



Neni 36

Quorumi, votimi, numri i votave

Në asambljetë e përgjithshme, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, quorumi llogaritet për tërësinë e aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë. E drejta e votës që u përket aksioneve është përpjestimore me kapitalin që ato përfaqësojnë.

Neni 37

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme

Asambleja e përgjithshme e zakonshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve të vitit pasardhës, për të vendosur mbi llogaritë e shoqërisë për ushtrimin financiar të mbyllur.

Ajo ka ndër të tjera, kompetencat që vijojnë:

- të miratojë strategjinë e zhvillimit afatgjatë të shoqërisë
- të miratojë plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- të miratojë, ndryshojë ose të hedhë poshtë llogaritë vjetore që janë shtruar për miratim;
- të vendosë për shpërndarjen dhe destinimin e rezultatin në pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.
- të shkarkojë me propozim të Këshillit Mbikqyrës, anëtarët e drejtorisë.
- të emërojë Ekspertin ose Ekspertët Kontabël të Autorizuar.
- të miratojë ose të mos miratojë emërimet e anëtareve të Këshillit Mbikqyrës të kryera nga vetë këshilli si emërimet të perkohshme.
- të miratojë pagën e drejtorit të saj dhe raportet e pagave për kategoritë e tjera të personelit të shoqërisë si dhe shpërblimet suplementare e mund të jepen për punë ose rezultate të mira.
- të caktojë shpërblimin e zakonshëm dhe shpërblime të tjera të parashikuara në këtë statut për Këshillin Mbikqyrës.
- të vendosë për raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar lidhur me marrëveshjet që i nënshtrohen autorizimit paraprak të Këshillit Mbikqyrës.


Asambleja e zakonshme merr çdo vendim që nuk sjell ndryshime të statutit. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë veçim, kur aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë jo më pak se 50 % të aksioneve me të drejtë votë dhe në rast se nuk arrihet kjo shumicë, do të merret parasysh vota e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili është gjithmonë i pranishëm në mbledhje. Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 38

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme.

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme mbledhet sa herë që duhet të merret një vendim që sjell ndryshime të këtij statuti.

Ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionerit përveç operacioneve që rredhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.



*



Neni 39

Vënia në dispozicion të aksionerëve të dokumentave dhe informacioneve

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionerëve, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja.

Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga asambleja, dokumentet që dafet u vihen në dispozicion aksionerëve u dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

KAPITULLI V **Kontrollorët e pavarur** **(Eksperti Kontabël i Autorizuar)**

Neni 40

Emërimi dhe shpërblimi

Asambleja e aksionerëve cakton një kontrollor të pavarur dhe një ndihmës të tij, të zgjedhur të dy nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Në caktimin e kontrollorëve të pavarur mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Kontrollorët e pavarur caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.

Shpërblimi i kontrollorëve të pavarur caktohet nga asambleja e aksionerëve dhe përballohet nga shoqëria.

Shoqëria Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. do të ketë një ekspert kontabël. Eksperti i parë kontabël i Shoqërisë do të jetë Z. Paqsor Qato


Neni 41

Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e kontrollorëve të pavarur të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e aksionerëve mund t'u kërkojë kontrollorëve të pavarur kryerjen e kontrollëve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Ekspertët kontabël të autorizuar thirren në mbledhjen e drejtorisë që mbyll llogaritë e vitit financiar të mbyllur si dhe në të gjitha asambletë e aksionerëve.

Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportët që ata përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.



KAPITULLI VI LLOGARITË VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 42 Viti financiar

Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin.
Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Neni 43 Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

KAPITULLI VII PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

Neni 44 Prishja, likujdimi

Në rastin e prishjes të shoqërisë një ose disa likuidatorë emërohen nga Asambleja e përgjithshme e aksionerëve në kushtet e quorumit dhe me shumicën e parashikuar për asamblatë e përgjithshme të zakonshme.
Likuidatori përfaqëson shoqërinë. Ai ka kompetenca të plota për të realizuar aktivin e shoqërisë, të shlyejë kreditorët dhe të shpërndajë mbetjen e disponueshme.
Ndarja e aktivit neto që mbetet pas rimbursimit të nominalit të aksioneve bëhet midis aksionerëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.


Neni 45 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe aksionerëve ose midis vetë aksionerëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VIII MARRDHËNIET E PUNËS.

Neni 46

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Kontratës së Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.



Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

Neni 47

Kontrata individuale e punës rregullon këto marrdhënie:
Marrja në punë, kushtet e të punësuarit për tu marrë në punë lloji i punës që do të kryeje i punësuarit, profesionet ndihmëse, koa e punës ditore e javore, pushimi ditor e javor, shpërblimi për kohën e punës, për periudhën jashtë kohës normale të punës, për punën e natës, për ditët e pushimit dhe të festave, shpërblimi për punë të dalluar. Përgjegjësitë e palëve për mos respektimin e kontratës.

Neni 48

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

KAPITULLI IX EMËRIMET E PARA

Neni 49

Këshilli Mbikqyrës

Si anëtare të këshillit të parë mbikqyrës emërohen nga aksionerët themelues të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. për një kohë prej tre vjetësh personat e mëposhtëm :

1. Mustafa Taçi;
2. Adriana Veizaj;
3. Drita Aliçkaj

të cilët kanë bërë të ditur që pranojnë funksionet respektive dhe pohojnë se nuk janë të prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tyre.


Neni 50

Ekspertët kontabël të autorizuar


Emërohet si Ekspertë Kontabël i Autorizuar i parë për një kohë prej 1 (një) viti financiar: **Zoti Paqsor Qato** i cili ka bërë të ditur që pranon funksionin e tij dhe pohon se nuk janë të prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tyre.

AKSIONERËT THEMELUES

Fatjon VEIZAJ



Rezart TAÇI



z. R. Pangjoti
07.05.2004
[Signature]

2 9696/1



KËRKESË

KËRKUES: Z. Petref Merkaç, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. i biri i Petraçit, i datëlindjes 14.01.1945, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0993322.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimi të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.A., datë 10.06.2004.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

66" depozitimi i vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. në Tiranë
1) Vendimi i Këshillit Mbikqyrës
I nderuar Zoti Kryetar, *07/10-06-2004 Nr 8518/518 Q1*

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit. *14-07-2004 CA. Robo*

Kërkuesi Z. Petref Merkaç, në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Këshillit Mbikqyrës të datës 10.06.2004. Këshilli u Mblodh për të diskutuar në lidhje me miratimin e dorëheqjes së drejtorit aktual të shoqërisë. Gjithashtu, Këshilli Mbikqyrës ka vendosur emërimin e Drejtorit të ri të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. *07/10-06-2004*

Ky vendim është marrë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Për sa më sipër, kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., datë 10.06.2004. *2004*

Depolita Kryetar
[Signature]

KËRKUES

Petref MERKAJ

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË



Nr. 8168 Rep.

Nr. — Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 07.07. 2004, para meje noterit Agim Xh. ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Petref Merkaj, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., i biri i Ismailit, i datëlindjes 14.01.1945, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, Rruga Dëshmorët e 4 Shkurtit, Sky Toëer, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0993322, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noter i vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER



**TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY SH.A.
KËSHILLI MBIKQYRËS
TIRANË**



**VENDIM I KËSHILLIT MBIKQYRËS
TË SHOQËRISË TAÇI OIL SH.A.**

Sot, më datë 10.06.2004, mbahet mbledhja e Këshillit Mbiqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" SH.A. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit Mbiqyrës të Shoqërisë, Z. Mustafa Taçi, Znj. Adriana Veizaj dhe Znj. Drita Aliçka.

Mbledhja ka këtë rend dite:

- Ndryshimi i Drejtorit të Shoqërisë;
- Të ndryshme.

Këshilli Mbiqyrës i Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., sipas pikës së parë të rendit të ditës, procedoi me shqyrtimin e dorëheqjes së paraqitur për arsye personale nga ana e Drejtorit aktual të shoqërisë Z. Rezart Taçi. Këshilli Mbiqyrës, e pranon këtë dorëheqjen dhe në mbështetje të nenit 12 të Statutit të Shoqërisë dhe të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", propozon emërimin si Drejtor të ri të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. të Zotit Petef Merkaj.

Për pikën e parë të rendit të ditës, anëtarët e Këshillit me unanimitet, miratojnë emërimin e Drejtorit të ri Z. Petref Merkaj.

Për sa më sipër dhe duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Këshilli Mbiqyrës në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare",

VENDOSI:

- 1- Të miratojë dorëheqjen e paraqitur nga Drejtori aktual i Shoqërisë dhe të emërojë Z. Petref Merkaj në funksionin e Drejtorit të ri të shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" SH.A.
- 2- Ngarkohet Drejtori i Shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në gjykatë..

PËR KËSHILLIN MBIKQYRËS TË

TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY SH.A.

Mustafa TAÇI

Mustafa Taçi
MTA

Adriana VEIZAJ

Adriana Veizaj

Drita ALIÇKAJ

Drita Aliçka
DA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 8518 Rep.
Nr. 588 Kol.

V È R T E T I M


Sot më datë 14.07.2004, para meje noterit Agim Xh. ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Mustafa Taçi, i biri i i datëlindjes 18.04.1934, lindur në Ersekë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 00773465, Znj. Adriana Veizaj, e datëlindjes 05.05.1968, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. 1371436 dhe Znj. Drita Aliçkaj, e datëlindjes 07.05.1945, lindur dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. Z 00773333, të tre me cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim Xh. ROBO



29896/2



KËRKESE

KËRKUES: Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimi të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.A., datë 17.06.2005.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

*6. Depozitimet
TIRANË
kërkese dt 24.06.05*

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuesi Z. Rezart Taçi, në cilësinë e Drejtorit të ri të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Këshillit Mbikqyrës të datës 17.06.2005. Këshilli u Mblodh për të diskutuar në lidhje me miratimin e dorëheqjes së drejtorit aktual të shoqërisë. Gjithashtu, Këshilli Mbikqyrës ka vendosur emërimin e Drejtorit të ri të Shoqërisë TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY Sh.a.

Ky vendim është marrë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Për sa më sipër, kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., datë 17.06.2005.

KËRKUES

Rezart TAÇI

Rezart Taçi

NOTER
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 8383 Rep.

Nr. Kol.

V È R T E T I M

Sot më datë 20/6 /2005, para meje noterit Agim Xh. ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noter i vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim Xh. ROBO





**TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY SH.A.
KËSHILLI MBIKQYRËS
TIRANË**

**VENDIM I KËSHILLIT MBIKQYRËS
TË SHOQËRISË TAÇI OIL SH.A.**

Sot, më datë 17.06.2005, mbahet mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" SH.A. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, Z. Mustafa Taçi, Znj. Adriana Veizaj dhe Znj. Drita Aliçka.

Mbledhja ka këtë rend dite:

- Ndryshimi i Drejtorit të Shoqërisë;
- Të ndryshme.

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., sipas pikës së parë të rendit të ditës, procedoi me shqyrtimin e dorëheqjes së përvokueshme të paraqitur nga ana e Drejtorit aktual të shoqërisë Z. Petref Merkaj. Këshilli Mbikqyrës, e pranon këtë dorëheqjen dhe në mbështetje të nenit 12 të Statutit të Shoqërisë dhe të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", propozon emërimin si Drejtor të ri të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a. të Zotit Rezart Taçi.

Për pikën e parë të rendit të ditës, anëtarët e Këshillit me unanimitet, miratojnë emërimin e Drejtorit të ri Z. Rezart Taçi.

Për sa më sipër dhe duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Këshilli Mbikqyrës në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare",

VENDOSI:

- 1- Të miratojë dorëheqjen e paraqitur nga Drejtori aktual i Shoqërisë dhe të emërojë Z. Rezart Taçi në funksionin e Drejtorit të ri të shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" SH.A.
- 2- Ngarkohet Drejtori i ri i Shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në gjykatë.

PËR KËSHILLIN MBIKQYRËS TË

TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY SH.A.

Mustafa TAÇI

Adriana VEIZAJ

Drita ALIÇKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 83/P2 Rep.


Nr. 728 Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 20/6 /2005, para meje noterit Agim Xh. ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Mustafa Taçi, i biri i i datëlindjes 18.04.1934, lindur në Ersekë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 00773465, Znj. Adriana Veizaj, e datëlindjes 05.05.1968, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. 1371436 dhe Znj. Drita Aliçkaj, e datëlindjes 07.05.1945, lindur dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. Z 00773333, të tre me cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim Xh. ROBO



29896/3

g. Blerime Muga
06.07.2005
06 KORIK

KËRKESË

KËRKUES: Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimi të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.A., datë 24.06.2005.



PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Kryetrit Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuesi Z. Rezart Taçi, në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, të datës 24.06.2005. Asamblea përveç të tjera për mbledhjene jashtëzakonshme ka vendosur për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY Sh.a. dhe për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin.

Ky vendim është marrë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Për sa më sipër, kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" Sh.a., datë 24.06.2005.

KËRKUES

Rezart TAÇI




REPUBLICA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 222 Rep.
Nr. — Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 6 / 7 /2005, para meje noterit Agim Xh. ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga “Dervish Hima”, Pall. “Klan”, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noter i vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim Xh. ROBO



Shoqëria tregtare
“Taçi Oil International
Trading & Supply Company” sh.a. Tiranë
Nr 02 prot.



Tiranë më 24 Qershor 2005

VENDIM I ASAMBLESË
SË ZAKONSHME DHE TË JASHTËZAKONSHME
TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
Nr 2 datë 20/06/2005

Sot më datë 20 Qershor 2005 u zhvillua mbledhja vjetore e asamblesë së zakonshme e deh të jashtëzakonshme të shoqërisë tregtare “**Taçi Oil International Trading & Supply Company**” sh.a. Tiranë, me rendin e ditës si më poshtë vijon:

Për Mbledhjen e Zakonshme:

1. Miratimi i rezultateve financiare për vitin ushtrimor 2004;
2. Miratimi i llogarive të fitimeve dhe humbjeve, bilancit, etj;
3. Miratimi i raportit të ekspertit kontabël për vitin ushtrimor 2004;
4. Mosshpërndarja e dividendit;
5. Zbritja e humbjeve

Për Mbledhjen e Jashtëzakonshme:

1. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë;
2. Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit.

Në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” asamblea e zakonshme e oratkëve të shoqërisë “**Taçi Oil International Trading & Supply Company**” sh.a. Tiranë pasi diskutoi lidhur me çështjet e përcaktuara në rendin e ditës vendosi si vijon:

1. Miratimin e Raportit të administrimit të shoqërisë për vitin financiar ushtrimor 01 janar 2004 deri më 31 dhjetor 2004.
2. Miratimin e llogarive vjetore, bilancin, llogarinë e fitimeve dhe humbjeve si dhe aneksin e bilancit, për vitin ushtrimor 2004 me treguesit kryesor ekonomik:

- Të ardhurat e ushtrimit	3 092 514 978 lekë
- Shpenzimet e ushtrimit	3 061 902 472 lekë
- Fitimi para tatimit	30 612 506 lekë
- Fitimi neto i ushtrimit	22 133 894 lekë

3. Miratimin e raportit të ekspertit kontabël të shoqërisë për vitin financiar ushtrimor 2004.

4. Miratimin që të mos shpërndahej dividend, por nga fitimi i vitit ushtrimor 2004 në shumën prej 22 133 894 lekë të zbritet humbja e mbartur e vitit 2003 në shumën për 4 686 616 lekë.
5. Nga fitimi i mbetur për shumën 17 447 278 lekë të bëhet zbritja e rezervës ligjore 5% të vlerës së kapitalit themeltar në shumën 200 000 lekë.

Në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" asambleja e jashtëzakonshme e oratkëve të shoqërisë "**Taçi Oil International Trading & Supply Company**" sh.a. Tiranë pasi diskutoi lidhur me çështjet e përcaktuara në rendin e ditës vendosi si vijon:

1. Për diferencën e fitimit të mbetur në shumën prej 17 247 278 lekë të bëhet kapitalizimi i tij, pra të zmadhohet kapitali themeltar i shoqërisë.
2. Emëron Z. Paqësor Qato si ekspert kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Asambleja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë "**Taçi Oil International Trading & Supply Company**" sh.a. Tiranë miratoi në unanimitet të plotë çështjet e mësipërme të pasqyruara në këtë vendim pa asnjë pretendim.


Asambleja ngarkon Drejtorin e Shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për sa i përket zmadhimit të kapitalit dhe emërimin të ekspertit për zmadhimin.

ASAMBLEA E AKSIONERËVE TË SHOQËRISË

"**TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY**" SH.A.


Rezart TAÇI

Rezart Taçi



Fation VEIZI

Fation Veizi





REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 9199 Rep.
Nr. 812 Kol.


VERTETIM

Sot me daten 04.07.2005 (pese), u prezantuan ne zyren noteriale, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, Tirane, zoterinjte Rezart Taçi (n. pasaporte 1899916) dhe Fatjon Veizaj (n. pasaporte Z0766087), si neneshkrues te vendimit te shoqerise "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" sh.a., te njohur prej meje por qe per identitetin e te cileve u sigurova edhe nga dokumentat perkatese te identifikimit dhe te shoqerive, madhor e me zotesi per te vepruar. Vendimi eshte konform Ligjit te shoqerive ne fuqi. Mbasi ju lexua permbajtja e aktit, deklaruan se e kuptojne dhe e pranojne ate, me vullnetin e tyre te lire firmosin para meje dhe une Noteri e legalizoj konform ligjit.



**INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE
AUTORIZUAR TE SHQIPERISE**

(IEKA)



L I C E N S E

Kjo license i lëshohet, PAQESOR ALI QATO

per te ushtruar profesionin e EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR.

*Kjo License lëshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit
te E. K. A. dhe mban numrin: 32, sipas kryej liste.*

PRESIDENTI

(BARI BERBERI)

Berberi



Lëshuar me: 10.02.2000

29896/4

25 NOV 2005
B. B. MUCI
25.11.2005
2005

KËRKESË

KËRKUES: Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë “Taçi Oil International Trading & Supply” Sh.a., i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga “Dervish Hima”, Pall. “Klan”, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimi të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Shoqërisë “Taçi Oil International Trading & Supply” Sh.a., datë 31.10.2005, për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autoruar për zmadhimin e kapitalit, zmadhimin e kapitali dhe për një ndryshim në Statutin e Shoqërisë.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 29896, datë 20.06.2003 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuesi Z. Rezart Taçi, në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të datës 31.10.2005. Asambleja e Jashtëzakonshme u mbledh për të diskutuar dhe vendosi në lidhje me për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autoruar për zmadhimin e kapitalit, zmadhimin e kapitalit dhe ndryshimin e nenit 5 të Statutit.

Ky vendim është marrë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”. Për sa më sipër, kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” Sh.a., datë 31.10.2005.

KËRKUES

Rezart TAÇI

Rezart Taçi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. 415 Rep.


Nr. Kol.

V È R T E T I M

Sot më datë 24.11 2005, para meje noteres Neriman Marika, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë “Taçi Oil International Trading & Supply” Sh.a., i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga “Dervish Hima”, Pall. “Klan”, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTERE

Neriman MARIKA


Neriman Marika



Tiranë më 31 Tetor 2005

**VENDIM I ASAMBLESE
SË JASHTËZAKONSHME
TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
Nr __ datë 31/10/2005**


Sot, më datë 31.10.2005, në selinë e shoqërisë tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a., u mbajt mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie, me rendin e ditës të bërë të njohur sipas rregullave në fuqi, si më poshtë vijon:

1. Miratimi i raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit;
2. Zmadhimi i kapitalit;
3. Për disa ndryshime në Statut.
4. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm të dy aksionerët, të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, duke legjitimuar vendimarrjen e kësaj asambleje.

Asamblea procedoi me diskutimin dhe miratimin e pikës së parë të rendit të ditës, miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar Z. Paqësor Qato për zmadhimin e kapitalit. Më datë 20.06.2005, Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të shoqërisë ka marrë vendim për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në të holla të aksionerëve dhe për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar. Sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për depozitimin e vendimit të sipërpërmendur dhe emërimin e ekspertit kontabël i autorizuar z. Paqësor Qato, është paraqitur nga ky i fundit raporti për zmadhimin e kapitalit, datë 06.10.2005, i cili parashikon zmadhimin e kapitalit nga vlera aktuale e kapitalit të nënshkruar prej 2.000.000 lekë në vlerën 19.247.278 lekë. Zmadhimi është realizuar nëpërmjet kontributit në të holla të përfaqësuar nga fitimet e mbartura dhe nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekszistuese nga 1000 në 9623,64 lekë. Po kështu sipas këtij raportit të prezantuar nga eksperti kontabël i autorizuar, aksionerët e shoqërisë do të kenë këtë pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë pas zmadhimit:

- Aksioneri Fatjon Veizi zotëron 45% të vlerës së aksioneve pas zmadhimit të kapitalit të shoqërisë që janë të barabarta me 900 numër aksionesh me vlerë 8.661.275 lekë;
- Aksioneri Rezart Taçi zotëron 55% të vlerës së aksioneve pas zmadhimit të kapitalit të shoqërisë që janë të barabarta me 1100 numër aksionesh me vlerë 10.586.003 lekë



Asamblea me unanimitet të aksionerëve të pranishëm vendos miratimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me të gjitha pikat, raport i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.

Sipas pikës së dytë të rendit të ditës dhe për sa u vendos në pikën e parë, Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. miraton zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 19.247.278 lekë dhe rritjen e vlerës nominale të një aksioni nga 1000 lekë në 9623,64 lekë, ku kontributi i secilit aksioner do të jetë sipas përqindjeve të përcaktuara në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për rritjen e kapitalit dhe që përputhet me përqindjet para zmadhimit të kapitalit.

Për sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, Aksionerët e shoqërisë, duke marrë shkas nga ndryshimi në kapitalin e shoqërisë, propozojnë ndryshimin e nenit 5 të Statutit si më poshtë vijon:

Neni 5 me këtë përmbajtje:
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 lekë. Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1000 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 2 000 aksione dhe janë të shpërndara në këtë mënyrë:

- 1- Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 900 numër të aksioneve me vlerë 900.000 lekë.
- 2- Zoti Rezart Taçi, zotëron 55 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 1100 numër të aksioneve me vlerë 1.100.000 lekë.


Ndryshon në këtë mënyrë

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 19.247.278 lekë. Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 9623,64 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 2 000 aksione dhe janë të shpërndara në këtë mënyrë:

- 1- Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 900 numër të aksioneve me vlerë 8.661.275 lekë.
- 2- Zoti Rezart Taçi, zotëron 55 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 1100 numër të aksioneve me vlerë 10.586.003 lekë.



Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, pas një diskutimi të gjatë të rendit të ditës, në mbështetje me Statutin e shoqërisë dhe Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, datë 06.10.2005 të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqësor Qato.
2. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nga 2.000.000 lekë në 19.247.278 lekë dhe rritjen e vlerës nominale të një kuote nga 1000 lekë në 9623,64 lekë.
3. Ndryshimin e dispozitës 5 të Statutit të Shoqërisë në këtë mënyrë:

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 19.247.278 lekë. Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 9623,64 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 2 000 aksione dhe janë të shpërndara në këtë mënyrë:

- 1- Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 900 numër të aksioneve me vlerë 8.661.275 lekë.
 - 2- Zoti Rezart Taçi, zotëron 55 %, të aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që janë të barabartë me 1100 numër të aksioneve me vlerë 10.586.003 lekë.
4. Ngarkohet Drejtori i shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

AKSIONERËT

Fatjon VEIZAJ

Fatjon Veizaj
Veizaj

Rezart TAÇI

Rezart Taçi
Taçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 413 Rep.

Nr. 45 Kol.

V È R T E T I M

Sot më datë 24 11 2005, para meje noteres Neriman MARIKA, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Z. Rezart Taçi, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916 dhe Fatjon Veizaj, i biri i Sulos, i datëlindjes 18.09.1966, lindur dhe banues në Vlorë, në adresën Lagjia "Kushtrimi" person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0134452 të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTERE

Neriman MARIKA

Neriman Marika
Neriman Marika



RAPORTI I ESKPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Objekti i Misionit :

Zmadhimi i kapitalit te nenshkruar bazuar ne vlerat kontabile te bilancit date 31.12.2004 te shoqerise tregtare *“Taçi Oil International Trading & Supply Company” sh.a Tirane*

Eksperti Kontabel i Autorizuar : Paqesor Qato


Data e krijimit te Shoqerise : 20.06.2003

Kapitali themeltar : 2 000 000 leke

Selia e Shoqerise : Tirane

Tirane me 06/10/2005

**Opinion per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise tregtare
"Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a Tirane
bazuar ne te dhenat e bilancit date 31.12.2004**



Shoqeria tregtare " Taçi Oil International Trading & Supply Company " sh.a Tirane eshte themeluar si person juridik me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr 29896 date 20.06.2003 . Me date 20 qershor 2005 ne mbledhjen e asamblese se zakonshme te aksionereve te shoqerise " Taçi Oil International Trading & Supply Company " sh.a Tirane eshte vendosur zmadhimi i kapitalit te neshkruar nga fitimi i mbartur ne vite dhe ai i periudhes te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj dhe qe nuk jane terhequr nga aksioneret e shoqerise.

Me vendimin e gjykates nr 29896/2 date 13/07/2005 eshte miratuar vendimi i asamblese se aksionereve per zmadhimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise i cili ne momentin e themelimit rezulton me nje vlere prej 2 000 000 leke i ndare me strukturen ne kapital si vijon:

- ◆ Aksioneri Fatjon Veizi zoteron 45 % te vleres se aksioneve ne kapitalin fillestar te shoqerise qe jane te barabarta me 900 numer te aksioneve me vlere 900 000 leke dhe vlere nominale per nje aksione 1000 leke
- ◆ Aksioneri Rezart Taçi zoteron 55% te vleres se aksioneve ne kapitalin fillestar te shoqerise qe jane te barabarta me 1100 numer te aksioneve me vlere 1 100 000 leke dhe vlere nominale per nje aksion 1000 leke

Ne reference te vendimit te gjykates ,bazuar ne te dhenat e bilancit kontabel date 31.12.2004 , ne kemi realizuar zmadhimin e kapitalit te nenshkruar nepermjet perfshirjes se rezervave ose te fitimeve te shoqerise duke rritur vleren nominale te aksioneve ekzistuese.

Aktualisht ne kemi analizuar dhe verifikuar strukturen e kapitaleve te veta, te shoqerise me date 31 dhjetor 2004 dhe ato perbehen si vijon :

◆ Kapitali i nenshkruar	2 000 000 leke
◆ Rezerva ligjore	0 leke
◆ Fitime dhe humbje te mbartura (humbjet)	(4 686 616) leke
◆ Fitime dhe humbjet te ushtrimit(humbjet)	22 133 894 leke
Totali kapitale te veta	19 447 278 leke

Ne vendimin e asamblese se zakonshme date 20/06/ 2005 eshte miratuar qe te mos shperndahet si dividend fitimi i vitit ushtrimor 2004 ne shumen 22 133 894 leke . Nga fitimi ushtrimor pasi te zbritet humbja e mbartur e vitit 2003 ne shumen 4 686 616 leke te behet krijimi e rezerves ligjore deri ne nivelin 1/10 se kapitalit themeltar ne shumen prej 200 000 leke .

Ne kete vendim te asamblese se zakonshme te aksionereve eshte miratuar qe me fitimin e mbetur ne vleren 17 247 278 leke te zmadhohet kapitali i nenshkuar i shoqerise .

Per ekzekutimin e mandatit te marre nga asambleja e zakonshme e aksionereve dhe gjykata e rrethit Tirane , ne lidhje me shtesen e kapitalit te nenshkuar, ne jemi bazuar ne dokumentet e meposhtme :

Situaten kontabel ne vecanti aktivin dhe pasivin sipas bilancit kontabel me 31.12.2004

- Ne dokumentet ligjore te shoqerise
- Ne vendimin e asambelse se zakonshme te aksionerve te Shoqerise per shtesen e kapitalit te nenshkuar.
- Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"
- Ligji nr. 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin"
- Ne Planin Unik Kontabel te vitit 1993

Pra kapitali i nenshkuar i shoqerise nga 2 000 000 leke qe ishte pas zmadhimit behet 19 247 278 leke dhe pjesmarria ne kapitalin e nenshkuar e aksionerve pas shteses se kapitalit eshte si vijon :

- ◆ Aksioneri Fatjon Veizi zoteron 45 % te vleres se aksioneve pas zmadhimit te kapitalit fillestar te shoqerise qe jane te barabarta me 900 numer te aksioneve me vlere 8 661 275 leke dhe vlera nominale per nje aksion nga 1000 leke behet 9623,64 leke per nje aksion
- ◆ Aksioneri Rezart Taçi zoteron 55% te vleres se aksioneve pas zmadhimit te kapitalit fillestar te shoqerise qe jane te barabarta me 1100 numer te aksioneve me vlere 10 586 003 leke dhe vlera nominale per nje aksion nga 1000 leke behet 9623,64 leke

Struktura e kapitaleve te veta pas kapitalizimit te fitimit ushtrimore do te jete:

◆ Kapitali i nenshkuar	19 247 278 leke
◆ Rezerva ligjore	200 000 leke
◆ Fitime dhe humbje te mbartura	0 leke
◆ Fitime dhe humnje te ushtrimit	0 leke
Totali kapitale te veta	19 447 278 leke

Ne perfundim te misionit konkludojme se kapitali i nenshkuar i shoqerise " Taçi Oil International Trading & Supply Company " sh.a Tirane ishte 2 000 000 leke dhe pas kapitalizimit te fitimit kapitali i nenshkuar behet 19 247 278 leke

Ky mision u realizua ne zbatim te vendimit te gjykates se rrethit Tirane nr 29896/2 date 13.07.2005

Eksperti Kontabel i Autorizuar
Paqesor Qato



Tirane me 06 Tetor 2005

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 414 Rep.


Nr. 46 Kol.


V Ë R T E T I M

Sot më datë 24.11 2005, para meje noteres Neriman Marika, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Z. Paqësor Qato, me cilësinë e ekspertit të Shoqërisë “Taçi Oil International Trading & Supply” Sh.a., lindur në Berat dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTERE

Neriman MARIKA


Neriman Marika



Emri dhe adresa e plote

Taçi Oil International Trading & Supply Company sh.a
Tirane

Data e krijimit

20.06.2003

Nr. i Regjistrimit tregëtar

29896

STATUSI JURIDIK

SHOQERI ANONIME

(Ndermarrje Shtetërore, Shoqeri Anonime, Shoqeri p. Kufizuar, etj)

VEPRIMTARIA KRYESORE

TREGETIM KARBURANTESH ME SHUMICE

LLOGARITE VJETORE
(Gjendjet financiare)

PERIUDHA Nga 01 Janar 2004 - 31 Dhjetor 2004

DATA E MBYLLJES 31/12/2004

MIRATUAR NGA Ek.Kontabel me date _____

Data e depozitimit _____

EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAQSOR QATQ



BILANCI

	AKTIVI	Nr	Para Shteses se Kapitalit	Pas Shteses se Kapitalit
A	KAPITALI I NENSHKRUAR I PA KERKUAR	1		
B	AKTIVE TE QENDRUESHME	2	75.996.357	75.996.357
	I) TE PA TRUPEZUARA	3	392.010	392.010
	a) Shpenzime te nisjes e te zgjerimit	4	522.010	522.010
	b) Shpenzime te kerkimeve te aplikuar e zhvillimeve	5		
	c) Te tjera ne shfrytezim	6		
	d) Pagesa pjesore te derdhura	7		
	e) Amortizime (-)	8	- 130.000	- 130.000
	h) Provizione per zhvleresim (-)	9		
	II) TE TRUPEZUARA	10	75.604.347	75.604.347
	a) Toka, troje, terrene, ndertime e inst. te pergj.	11	57.600.000	57.600.000
	b) Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	12	13.291.246	13.291.246
	c) Te tjera ne shfrytezim	13	8.122.001	8.122.001
	d) Ne proces dhe pagesa pjesore	14		
	e) Amortizime (-)	15	- 3.408.900	- 3.408.900
	h) Provizione per zhvlersime (-)	16		
	III) FINANCIARE	17	-	-
	a) Pjesmarrje dhe tituj financiar te tjere	18		
	b) Kerkesa debitore te lidhura me pjesmarrjet	19		
	c) Kredi te dhena	20		
	d) Provizione per zhvleresim (-)	21		
C	AKTIVE QARKULLUESE	22	571.254.618	571.254.618
	I) GJENDJE TE INVENTARIT DHE NE PROCES	23	464.864.373	464.864.373
	a) Materiali te para dhe materiale te tjera	24	1.683.117	1.683.117
	b) Prodhime, punime, sherbime ne proces	25		
	c) Produkte dhe mallra	26	463.181.256	463.181.256
	d) Te tjera gjendje inventari	27		
	e) Provizione per zhvleresim (-)	28		
	II) KERKESA PER ARKETIM MBI DEBITORET	29	104.375.018	104.375.018
	Nga keto me afat pas me shume se nje viti			
	a) Kliente per shitje, sherbime	30	23.833.430	23.833.430
	b) Ortake kapital i paderdhur	31		
	c) Personeli dhe persona	32		
	d) Te tjera kerkesa	33	80.541.588	80.541.588
	e) Provizione per zhvleresim (-)	34		
	III) LETRA ME VLERE TE VENDOSJES PERKOHSHME	35	-	-
	a) Aksione, obligacione, bono thesari dhe te ngjashme	36		
	b) Provizione per zhvleresim (-)	37		
	IV) LIKUIDITETE DHE VLERA ARKE TE TJERA	38	2.015.227	2.015.227
	a) Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera	39	1.985.547	1.985.547
	b) Para ne dore (arke)	40	29.680	29.680
	c) Vlera arke te tjera	41		
	V) SHPENZIME TE PAGUARA OSE REGJ. AVANCE	42		
	Nga keto: Mbi nje viti			
D	LLOGARI TE TJERA	43	240.474	240.474
	a) Shpenzime (kosto) per t'u shperndare	44		
	b) Diferenca konvertimi AKTIVE	45	240.474	240.474
	TOTALI I AKTIVIT	46	647.491.449	647.491.449
	LLOGARI JASHT BILANCIT	47	-	-
	Aktive te qendrueshme te marra me qira	48		
	Pasuri te tjera te te treteve	49		
	Te tjera llogari jashte bilancit	50		

KONTABEL
AUTORIZUAR
PAQSOR QAT



BILANCI

	PASIVI	Nr	Para Shteses se Kapitalit	Pas Shteses se Kapitalit
A	KAPITALET E VETA	51	19.447.278	19.447.278
I	KAPITALI THEMELTAR REZERVAT FITIME/HUMBJE	52	19.447.278	19.447.278
	Nga ky i derdhur			
	a) Kapitali i nenshkuar	53	2.000.000	19.247.278
	b) Prime te lidhura me kapitalin	54		
	c) Diferenza nga rivlersimi	55		
	d) Rezervat	56	-	200.000
	Rezerva ligjore	57		200.000
	Rezerva statutore	58		
	Rezerva te tjera	59		
	e) Fitimi ose humbje te mbarura (Humbjet -)	60	4.686.616	-
	h) Fitimi ose humbje te ushtrimit (Humbjet -)	61	22.133.894	-
II	FONDE TE TJERA TE VETAT (Nd. Shtetore)	62	-	-
	a) Fondi (Rezerva) i zhvillimit	63		
	b) Fondi i shperblimit suplementar te punonjesve	64		
	c) Fondi i ndihmave te menjehershme	65		
	d) Fondi te tjera	66		
III	SUBVENCIONE PER INVESTIME	67		
IV	PROVIZIONE PER RREZIQE E SHPENZIME	68	-	-
	a) Provizione per rreziqe	69		
	b) Provizione per shpenzime	70		
B	DETYRIME	71	621.395.514	621.395.514
I	DETYRIME TE KERKUESHME PAS ME SHUME NJE VIT	72	71.296.216	71.296.216
	a) Huara nga bankat dhe institutet e kreditit	73	60.916.216	60.916.216
	b) Huara te tjera	74	10.380.000	10.380.000
	c) Shuma te arketuara per porosi	75		
	d) Furnitore per blerje e sherbime	76		
	e) Shteti	77		
	h) Ortake	78		
	f) Te tjera detyrime	79		
II	DETYRIME TE KERKUESHME DERI NE NJE VIT	80	550.099.298	550.099.298
	a) Huara nga bankat dhe institutet e kreditit	81	103.240.600	103.240.600
	b) Huara te tjera	82		
	c) Shuma te arketuara per porosi	83		
	d) Furnitore per blerje e sherbime	84	378.614.601	378.614.601
	e) Personeli	85	86.650	86.650
	h) Sigurime shoqerore dhe te ngjashme	86	41.331	41.331
	f) Shteti - tatime dhe taksa	87	4.980.674	4.980.674
	g) Ortake	88	30.532.369	30.532.369
	i) Te tjera detyrime	89	32.603.073	32.603.073
III	TE ARDHURA TE MARRA OSE TE REGJ. AVANCE	90		
C	LLOGARI TE TJERA	91	6.648.657	6.648.657
	a) Diferenca konvertime pasive	92	6.648.657	6.648.657
		93		
	TOTALI I PASIVIT	94	647.491.449	647.491.449
	LLOGARI JAShte BILANCIT	95		
	Aktive te qendrueshme te marra me qira	96		
	Pasuri te tjera te te treteve	97		
	Te tjera llogari jashte bilancit	98		
		99		

EKSPERT KONTABEL
 I AUTORIZUAR
 PASOR QATO





29896/5

zj: B. Musa
dt. 10.04.2007
10 APR. 2007
found

KËRKESË

Kërkes:

Rezart Taçi, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07/06/1971, lindur e banues në Tiranë, Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.

Objekti:

Depozitimi në Regjistrin Tregtar të Vendimit Nr.6 datë 02/04/2007 të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë dhe të kontratës së shitblerjes së aksioneve dhe pasqyrimi i ndryshimeve.

Baza ligjore:

Ligji Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar".

Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë

z. Depo e kaset

Shoqëria "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. është regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.29896 datë 20/06/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë me Vendimin Nr.6 datë 02/04/2007 ka vendosur:

1. Miratimin e shitjes së 45 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., të zotëruara nga aksionari Fation Veizaj tek aksionari z. Rezart Taçi.
2. Me transferimin e pronësisë së 45 % të aksioneve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. tek aksionari z. Rezart Taçi, z. Fation Veizaj çlirohet nga çdo detyrim i tij personal ndaj shoqërisë apo të tretëve dhe çdo garanci apo dorëzani e tij personale, dhënë të tretëve për shoqërinë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., hiqet duke dhënë garanci apo duke u bërë dorëzanës për to aksionari z. Rezart Taçi.
3. Me realizimin e shitjes, çdo barrë e vendosur mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme të z. Fation Veizaj për llogari të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. hiqet në mënyrë imediate e definitive dhe detyrimin për të garantuar të tretët e merr përsipër aksionari z. Rezart Taçi.
4. Ndryshimin e Nenit 5 të Statutit të shoqërisë për sa i përket përbërjes së aksionarëve dhe zotërimit të aksioneve të kapitalit, që ndryshon dhe bëhet si më poshtë:
 - z. Rezart Taçi zotëron 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë që janë të barabarta me 2000 aksione, me vlerë 19.247.278 lekë.
5. Pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijim të këtij vendimi është nënshkruar dhe kontrata e shitblerjes së aksioneve nr.487 rep., nr.147 kol., datë 05/04/2007 e noteres Sofika Braka.


Në këto kushte kërkoj depozitim të Vendimit Nr.6 datë 02/04/2007 të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë dhe të Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve Nr.487 Rep., Nr.147 Kol., datë 05/04/2007 dhe pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar.

KERKUES

Drejtori i Përgjithshëm

Rezart Taçi

Rezart Taçi




Republika e Shqipërisë

Noteria Tiranë

Nr. 488 Rep.

VERTETIM

Vërtetohet se sot më 05/04/2007, në Tiranë, para meje Sofika Braka, Notere me seli në rrugën "Ismail Qemali", pall.11/1, u paraqit personalisht, z. **Rezart Taçi**, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07/06/1971, lindur e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr. Z1263288, i cili deklaroi se ka hartuar këtë kërkesë jashtë kësaj zyre dhe nënshkroi para meje rregullisht. Unë, Noteri vërtetoj me nënshkrimin tim sipas ligjit.



NOTERE

Sofika Braka

Sofika Braka



Shoqëria "TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY CO" Sh.A.

VENDIM

LASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË

Nr.6 datë 02/04/2007

Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. në mbledhjen e saj të jashtëzakonshme të datës 02/04/2007, me pjesëmarrjen e të dy aksionarëve z. Rezart Taçi e z. Fation Veizaj, që zotërojnë 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar, unanimisht

VENDOSI

1. Miratimin e shitjes së 45 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., të zotëruara nga aksionari Fation Veizaj tek aksionari z. Rezart Taçi.
2. Me transferimin e pronësisë së 45 % të aksioneve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. tek aksionari z. Rezart Taçi, z. Fation Veizaj çlirohet nga çdo detyrim i tij personal ndaj shoqërisë apo të tretëve dhe çdo garanci apo dorëzani e tij personale, dhënë të tretëve për shoqërinë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., hiqet duke dhënë garanci apo duke u bërë dorëzanës për to aksionari z. Rezart Taçi.
3. Me realizimin e shitjes, çdo barrë e vendosur mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme të z. Fation Veizaj për llogari të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. hiqet në mënyrë imediate e definitive dhe detyrimin për të garantuar të tretët e merr përsipër aksionari z. Rezart Taçi.
4. Ndryshimin e Nenit 5 të Statutit të shoqërisë për sa i përket përbërjes së aksionarëve dhe zotërimit të aksioneve të kapitalit, që ndryshon dhe bëhet si më poshtë:
 - z. Rezart Taçi zotëron 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë që janë të barabarta me 2000 aksione, me vlerë 19.247.278 lekë.
5. Pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

AKSIONARET E SHOQËRISË

Fation VEIZAJ

Fation Veizaj
[Signature]

Rezart TAÇI

Rezart Taçi
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 486 Rep.

Nr. - Kol.

VERTETIM

Në Tiranë, sot më datë 05/04/2007, para meje Noteres Sofika Braka, me seli në rrugën "Ismail Qemali", u paraqitën personalisht:

- z. **Rezart Taçi**, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07/06/1971, lindur e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr. Z1263288;

- z. **Fation Veizaj**, i biri i Sulos, i datëlindjes 18/09/1966, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr.Z0763087;

në cilësinë e aksionarëve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., të cilët deklaruan se ky akt i hartuar prej tyre jashtë kësaj zyre noteriale është në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e nënshkruajnë rregullisht para meje. Unë, noteri e legalizoj sipas ligjit.

NOTERE
Sofika Braka



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 487 Rep.

Nr. 107 Kol.



KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 05/04/2007, perpara meje Noteres Sofika Braka, me adrese ne rrugen "Ismail Qemali", pall.11/1, u paraqiten personalisht personat e poshteshenuar per lidhjen e kesaj kontrate shitblerje aksionesh te kapitalit te shoqerise:

Shitesit:

- z. **Fation Veizaj**, i biri i Sulos, i datëlindjes 18/09/1966, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr.Z0763087;

Bleresi:

- z. **Rezart Taçi**, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07/06/1971, lindur e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr.Z1263288.

Neni 1

- 1.1 Shitesi dhe Bleresi jane aksionare te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. me seli ne Tirane, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.29896 date 20/06/2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 1.2 Shitesi zoteron 900 aksione ose ndryshe 45 % te aksioneve te kapitalit te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.
- 1.3 Keto aksione qe zoterohen prej tij, te cilat perbejne 45 % te aksioneve te kapitalit te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., ia shet Bleresit i cili pranon t'i bleje ato, sipas kushteve te percaktuara me poshte ne kete kontrate.

Neni 2

2.1 Cmimi i shitjes se 900 aksioneve, ose ne perqindje 45 % te kapitalit te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. është me vleren e tyre nominale prej 8.661.275,1 leke.

Ky cmim i eshte paguar Shitesit ne daten e sotme jashte kesaj zyre noteriale.

Neni 3

Pervec cmimit te shitjes se aksioneve, Bleresi deklaron se i detyrohet Shitesit edhe nje shume prej 1.200.000 (nje milione dyqind mije) USD te cilen do t'ia shlyeje per nje deri me daten 31/12/2007, duke e shlyer me keste nga 120.000 USD cdo muaj. Pagesa do te behet cdo date 15 - 20 te cdo muaji. Diferencat do te likuidohen deri ne daten e percaktuar.

3.2 Ne rast se Bleresi nuk shlyen detyrimin e njohur ne afatin e percaktuar, atehere kjo kontrate do te konsiderohet e zgjidhur dhe Shitesit i lind e drejta te kerkoje menjehere rikthimin ne pronesi te aksioneve duke i drejtuar Bleresit nje njoftim me shkrim per kryerjen e nje veprimi te tille dhe njekohesisht te kerkoje rikthimin ne pronesi te tij duke u bere shenimet perkatese edhe ne Regjistrin Tregtar nepermjet nje kerkese me kalimin e nje afati 15 ditor nga data e marrjes dijeni per njoftimin prej Bleresit. Kjo klauzole (3.2) do te aplikohet edhe per shitjen e kuotave te shitesit ne shoqerine "Kuid" sh.p.k. dhe me vertetimin e rastit te parashikuar ne kete klauzole te kontrates (3.2), shitesit do t'i rikthehen ne pronesi ne te njejten menyre edhe 50 % e kuotave ne shoqerine "Kuid" sh.p.k.

3.3 Ne rast se Bleresi, ne afatin 15 ditor pas marrjes se njoftimit, permbush detyrimin, atehere kontrata do te konsiderohet e vlefshme, pagesa e plote e likuiduar.

Neni 4

4.1 Me shitjen e ketyre aksioneve dhe likuidimin e plote te detyrimit te njohur, Shitesi z. Fation Veizaj largohet nga pjesemarrja e metejshme si aksionar ne shoqerine "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.



4.2 Ne kete menyre perberja e aksionareve ne shoqerine "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. ndryshon dhe behet si me poshte:

- z. Rezart Taçi zotëron 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë që janë të barabarta me 2000 aksione.


4.3 Me realizimin e kesaj shitblerje te ketyre aksioneve te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., Bleresit i transferohen te gjitha te drejatat e detyrimet qe rrjedhin nga blerja e tyre.

4.4 Me transferimin e pronësisë së 45 % të aksioneve të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. tek Bleresi, aksionari z. Rezart Taçi, Shitesit, z.Fation Veizaj, çlirohet nga çdo detyrim i tij personal ndaj shoqërisë apo të tretëve dhe çdo garanci apo dorëzani e tij personale, dhënë të tretëve për shoqërinë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., hiqet duke iu tranferuar detyrimi per te dhënë garanci e duke u bërë dorëzanës për to aksionari i vetem z. Rezart Taçi.

4.5 Me realizimin e kesaj shitje, cdo barre e vendosur mbi pasurite e luajtshme apo te paluajtshme te z. Fation Veizaj per llogari te shoqerise "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. hiqet ne menyre imediate e definitive dhe detyrimin per te garantuar te tretet e merr persiper bleresi z. Rezart Taçi.

4.6 Palet bien dakort dhe Bleresi pranon qe deri ne likuidimin e plote te detyrimit te shprehur ne paragrafin 3.1 te kontrates, ne rast se Bleresi nuk shlyen qofte edhe nje pagese ne afatet e percaktuara, mbi keto aksione do te vendoset barre e do te qendrojne te bllokuara ne favor te shitesit si kreditor i pare preferencial, duke u bere dhe shenimi per kete qellim ne Regjistrin Tregtar dhe duke u pasqyruar edhe ne Regjistrin e Barreve Siguruese. Ky bllokim do te hiqet menjehere me likuidimin e plote te te gjithë detyrimit dhe leshimin e nje deklarate noteriale nga ana e Shitesit per likuidimin e vleres se plote te cmimit te shitblerjes se aksioneve dhe te detyrimit te shprehur ne paragrafin 3.1 te kontrates.

4.7 Eshte kusht dhe detyrim i pranuar nga Bleresi qe, deri ne likuidimin e vleres se plote te detyrimit qe ka Bleresi ndaj Shitesit, si per shoqerine "Taci Oil International Trading & Supply Company" sh.a., ashtu edhe per shoqerine "Kuid" sh.p.k., nuk do te kryhet asnje shitje e aksioneve te kesaj shoqerie dhe nuk do te vendoset asnje barre mbi to apo te



vendosen si garanci. Bleresi ka detyrimin qe te njoftoje per cdo veprim te tille Shitesin dhe veprime te tilla do te kryhen vetem pas aprovimit me shkrim te shitesit. Ne rast se do te kryhet nje veprim i tille pa miratimin me shkrim te Shitesit, atehere cdo kontrate e nenshkruar nga Bleresi dhe/ose cdo veprim tjeter juridik i kryer me keto pasoja mbi aksionet, do te jete absolutisht i pavlefshem, duke qene i detyruar Bleresi te shperbleje edhe demin e shkaktuar nga kryerja e nje veprimi te tille.

4.8 Ne rast se gjate periudhes qe nuk eshte likuiduar vlera qe Bleresi i detyrohet Shitesit, gjate veprimtarise tregtare, per nevoja te shoqerise, do te jete e nevojshme vendosja e barreve apo lenia peng e aksioneve te shoqerise, ne cdo rast, Bleresi merr persiper detyrimin dhe do te vere ne dijeni te tretet per kete kusht mbi 45 % te aksioneve te shoqerise dhe nuk do te lejohet prekja e pozites si kreditor i pare i shitesit deri ne momentin e shlyerjes se vleres se plote te detyrimit. Perjashtim do te beje rasti kur shitesi do te jape pelqimin e tij me shkrim per ndryshimin e nje pozite te tille apo heqjen e barres dhe shenimit te vendosur.

Neni 5

Shitesi deklaron se ia shet keto aksione te kapitalit te shoqerise, Bleresit, te lira nga cdo detyrim, barre apo pretendim nga te trete; aksionet, te drejtat mbi to, nuk jane te perfshira ne procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo te cfaredo lloj natyre tjeter qe te mund te jete shkak per cenimin e kontrates.

Neni 6

6.1 Palet deklarojne se do te zbatojne rigorozisht te gjitha te drejtat e detyrimet e tyre qe rrjedhin nga kjo kontrate.

6.2 Ne rast mosmarreveshje midis tyre ne zbatim te kesaj kontrate, palet do te bejne te gjitha perpjekjet per zgjidhjen e tyre me mirekuptim. Ne rast se nuk do te arrijne ne zgjidhje me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.



Kjo kontrate hartohet ne 5 (pese) kopje me te njejten vlere ligjore dhe palet pasi e lexuan dhe e gjeten ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire e nenshkruajne pa verejtje ne pranine time. Une noteri e legalizoj sipas ligjit.

PALET KONTRAKTORE

SHITESI

Fation VEIZAJ

Fation Veizaj
Fuz

BLERESI

Rezart TAÇI

Rezart Taçi
[Signature]

NOTERE

Sofika Braka

[Signature]



22896

zj. A. Ceppo
20.06.2003



KËRKESË

KËRKUES: Rezart Taçi, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv.

OBJEKTI : Regjistrimin si person juridik në Regjistrin Tregtar, të Shoqërisë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË.

I nderuar Zoti Kryetar,

Në mbështetje të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në kriteret dhe mundësinë që vendos ky ligj, për ushtrimin e aktivitetit si person juridik, kërkojmë regjistrimin si të tillë të shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a.

Shoqëria Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- blerjen, importimin, shitjen e naftës dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- blerjen, importimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzjerjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzimeve dhe i garancive të tjera.

Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. do të jenë Fatjon Veizaj dhe Rezart Taçi. Kontributi i secilit në kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë : Fatjon Veizaj, zotëron 45%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë; Rezart Taçi, zotëron 55%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë;

Shoqëria do të ketë si anëtarë të parë të Këshillit Mbikqyrës z. Mustafa Taçi, zj. Adriana Veizaj dhe zj. Drita Aliçkaj. Drejtor i Shoqërisë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a. do të jetë aksioneri themelues Rezart Taçi.

KËRKUES

Rezart TAÇI

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 7185 Rep.

Nr. _____ Kol.



V Ë R T E T I M

Sot më datë 19.06. 2003, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Rezart Taçi, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Tv Klan", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noter i vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim ROBO

PULLE TAKSE



RISHQIPTERISE



Banka Amerikane
e Shqipërisë



American Bank
of Albania

KONTRATË THEMELIMI
E
SHOQËRISË ANONIME
"TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY" SH.A.



Me cilësinë e aksionerëve themelues :

1. Fatjon Veizaj, i biri i Sulos, i datëlindjes 18.09.1966, lindur dhe banoës në Vlorë, në adresën Lagjia "Kushtrimi", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0134452.
2. Rezart Taçi, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Tv Klan", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916.

si themelues të Shoqërisë Anonime "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., kanë vendosur sa më poshtë:

NENI 1

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., në formën e një Shoqërie Anonime pa ofertë publike. Sh.a. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. ose shkurtimi "TATRASCO" Sh.a.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është realizimi i fitimit nëpërmjet veprimtarisë ekonomike që ajo do të ushtrojë.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprures.

Si qëllim final Shoqëria do të ketë realizimin, e veprimtarisë ekonomike dhe nëpërmjet saj do të synojë realizimin e tregueseve ekonomike dhe sociale.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë, afati

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a. ose me shkurtimin "TATRASCO" sh.a. dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje pa afat.

NENI 4

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj :

- blerjen, importimin, shitjen e naftës dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- blerjen, importimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit,

lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;

- blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;

gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

NENI 5

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga “Dëshmorët e Shkurtit”, Pall. “Sky Tower”, kati 4, Tiranë.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i aksionerëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 2.000.000 lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë pa ofertë publike, shumë e derdhur tërësisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi nga aksionerët themelues të kësaj Shoqërie.

Shoqëria ka të depozituar në Bankën “Banka Amerikane” dega Tiranë, kapitalin në të holla.

NENI 7

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.000 aksionë me vlerë nominale prej 1.000 lekë.


Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare “Taçi Oil International Trading & Supply Company” Sh.a. zotërojnë aksionet në këtë shoqëri të ndara si më poshtë :

1. Zoti Fatjon Veizaj, zotëron 45% të akcioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë, që janë të barabarta me 900 numër të akcioneve me vlerë 900.000 lekë.
2. Zoti Rezart Taçi, zotëron 55%, të akcioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë, që janë të barabarta me 1.100 numër të akcioneve me vlerë 1.100.000 lekë.

NENI 8

Transferimi i akcioneve dhe rregulla mbi disponimin e pasurisë

Përveç rastit të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet tek një i tretë, pavaresisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga Asamblea e Aksionerëve duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.



NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Asambleja e Aksionerëve, e cila përfaqësohet nga aksionerët themelues të shoqërisë që përfaqësojnë në këtë Asamble vlerën e përgjithshme të aksioneve në kapitalin themelues të Shoqërisë.

NENI 10

Drejtoria e Shoqërisë

Drejtoria e Shoqërisë përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv.

Drejtori Ekzekutiv emërohet për një periudhë kohe të pakufizuar.

Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" Sh.a., do të jetë aksioneri themelues zoti Rezart Taçi.

Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës, për periudhën kohore të shprehur si më sipër.

NENI 11

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë

Përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë :

1. Mustafa Taçi
2. Adriana Veizaj
3. Drita Aliçkaj

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë jo më shumë se tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 12


Ekspert kontabël të autorizuar të shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjet në fuqi dhe për çdo vit financiar të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë. Shoqëria do të ketë një ekspert kontabël. Eksperti i parë kontabël do të jetë zoti Paqsor Qato.

NENI 13


Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e statutit.

AKSIONERËT THEMELUES


Fatjon VEIZAJ



Rezart TAÇI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 7268 Rep.
Nr. 865 Kol.



VËRTETIM


Sot më datë 15/6/ 2003, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Rezart Taçi, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Tv Klan", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916 dhe Fatjon Veizaj, i biri i Sulos, i datëlindjes 18.09.1966, lindur dhe banues në Vlorë, në adresën Lagjia "Kushtrimi", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0134452, të dy me cilësinë e aksionerëve themelues të shoqërisë "MEDI OIL" sh.a., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 7288 Rep.

Nr. 864 Kol.



V Ë R T E T I M

Sot më datë 19/6/ 2003, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Rezart Taçi, i biri i Mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Tv Klan", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916 dhe Fatjon Veizaj, i biri i Sulos, i datëlindjes 18.09.1966, lindur dhe banues në Vlorë, në adresën Lagjia "Kushtrimi", person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 0134452, të dy me cilësinë e aksionerëve themelues të shoqërisë "MEDI OIL" sh.a., të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

